



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:173020  
Datë: 05.08.2024  
Numri i dokumentit: 06019073

**K.DH.Shk.II.nr.606/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agronomi Group” Sh.P.K., me seli në Suharekë, Zona Industriale, kundër debitorit “AgroKosova Holding” Sh.P.K., me seli në Suharekë, Zona Industriale-Shirokë, me NUI: 810522894, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Alija Ajro, avokat nga Prizreni, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2446/22 të datës 04.01.2022, me datë **24.05.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Agronomi Group” Sh.P.K, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2446/22 të datës 04.01.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2446/22 të datës 04.01.2022, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “AgroKosova Holding” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.334/2022 i datës 27.06.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2446/22 të datës 04.01.2022, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se sipas vendimit të Gjykatës Supreme-Dhomave të gjitha faturat e lëshuara në raport me debitorin “AgroKosova Holding” Sh.p.k, u mungonte raporti juridik si dhe faturat janë pranuar por nuk dihet se nga kush janë pranuar pasi që debitori ka qenë nën menagjimin e AKP-së. Andaj, ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë që ankesën e kreditorit ta refuzoj si të pabazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Agronomi Group” Sh.P.K., ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumenteve të besueshme-faturave: faturës Nr.22-SHV01-002-97 e datës 22.04.2022, faturës Nr.22-SHV01-002-158 e datës 06.05.2022, faturës Nr.22-SHV01-002-200 e datës 11.05.2022, faturës Nr.22-SHV01-002-201 e datës 17.05.2022, faturës Nr.22-SHV01-002-202 e datës 23.05.2022, dhe faturës Nr.22-SHV01-002-203 e datës 25.05.2022, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga faturat e lartcekura, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 58,828.00 Euro, me kamatë vonesë prej 8% vjetore, dhe atë nga data e skadimit të afatit për pagesën e secilës faturë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se nuk dihet si ka ardhur raporti juridik ndërmjet kreditorit dhe debitorit gjatë periudhës prill dhe maj 2022, pasi që dihet se gjatë kësaj periudhe debitori ka qenë nën menaxhimin e AKPsë, ku në rastin konkret nuk dihet burimi i këtij detyrimi nëse është lidhur ndonjë kontratë për furnizim. Tutje ka shtuar se debitori nuk ka asnjë raport me shkrim me kreditorin dhe si fakt ka përmendur kontratën për qiradhënie të lidhur ndërmjet “AgroKosova Holding” Sh.P.K., dhe subjektit “Suhareka Verari” Sh.P.K., ku qiramarrësi ka marrë gjithçka që posedon në rastin konkret debitori, dhe një gjendje e tillë është jo ligjore. Ka theksuar se dokumenti i besueshëm, faturat, me të cilat është inicuar procedura përmbartimore janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 27 par.1 dhe 29 par.3 të LPP-së, ngase dokumentit të tillë i mungon përshtatshmëria për t’u konsideruar dokument i përmbartueshëm, pasi që i mungon raporti, pra kontrata për bashkëpunim afarist. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për përmbartim i Përmbartuesit Privat.

Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se nuk është i bazuar më asnjë dispozitë ligjore të LPP-së. Lidhur me pretendimet e debitorit se ka vendim se i njëjti ka qenë nën administrimin e AKP-së dhe se ekziston kontrata mbi qiranë, kreditori ka theksuar se asnjëra nga këto dokumente nuk kanë efekt

dhe nuk paraqesin dokument përbarimor, dhe se të dyja këto dokumente janë akte të brendshme të debitorit me palët tjera të cilat assesi nuk ndryshojnë raportin që ka si debitor dhe borxhin që i ka kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri përbarimor, dhe të obligohet debitori t'i paguajë shpenzimet për avokatin sipas tarifës nr.9 të OAK-së, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2446/22 të datës 04.01.2022, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “AgroKosova Holding” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr.334/2022 i datës 27.06.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka gjetur se fatura Nr.22-SHV01-002-97 e datës 22.04.2022, fatura Nr.22-SHV01-002-158 e datës 06.05.2022, fatura Nr.22-SHV01-002-200 e datës 11.05.2022, fatura Nr.22-SHV01-002-201 e datës 17.05.2022, fatura Nr.22-SHV01-002-202 e datës 23.05.2022, dhe fatura Nr.22-SHV01-002-203 e datës 25.05.2022, në bazë të së cilave është lejuar përbarimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat janë dorëzuar dhe janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohej se faturat janë dorëzuar me rregull dhe janë pranuar nga debitori pa kundërshtim.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar. Sipas Udhëzimit administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parashihet se “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, ndërsa neni 29 paragrafi par.3 i Ligjit të Procedurës Përbarimore përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Dhoma e Shkallës së dytë bazuar në dispozitat e lartcekura vlerëson se faturat kontestuese dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, përmbajnë nënshkrimin tek pranuesi i faturave mirëpo sipas vendimit nr.ref. BD-158/2 të datës 31.01.2022 të nxjerrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) debitori në kohën kur është lëshuar fatura ka qenë i vendosur nën administrimin direkt të AKP-së, dhe rrjedhimisht, nënshkrimi në këto fatura, nuk është i mjaftueshëm për të identifikuar se a është bërë dorëzimi i rregullt i faturave lëndore tek debitori apo dorëzimi i këtyre faturave është bërë pranë AKP-së, si organ që ka menaxhuar me debitorin deri në muajin maj të vitit 2022, ku sipas vendimit AC-I-22- 0227 të datës 23 maj 2022, të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës-Dhoma e Posaçme, menaxhimi i debitorit i është kthyer përsëri pronarëve të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit në ankesë, por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.Shk.II.nr.606/24 me datë 05.08.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**